



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTREZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR PËR VITIN 2023**

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke vlerësuar rolin e Prokurorisë së Posaçme në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatës së Lartë;
- Duke vlerësuar pavarësinë institucionale të Prokurorisë së Posaçme në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- Duke vlerësuar rritjen e besimit të publikut dhe të institucioneve ndërkombëtare ndaj Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

Vlerëson veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2023, për përmbushjen e funksioneve në këto drejtime:

- Përmirësimin të treguesve statistikore të hetimeve të ndërmarra nga Prokuroria e Posaçme, veçanërisht për hetimet e nisura kryesisht, të interceptimit me pajisje fundore dhe të kërkesave për ndihmë juridike nga jashtë vendit, të cilat në krahasim me vitin 2022 kanë shënuar rritje të numrit respektivisht me 139%, 91% dhe 95%.

- Rritjes së numrit dhe përmirësimit të hetimeve dhe konfiskimeve të pastrimit të parave, si rezultat i të cilave u miratua vendimi për daljen e Shqipërisë nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar, njohur ndryshe si “lista gri” e MONEYVAL.
- Bashkëpunimit të mirë e të vazhdueshëm me agjencitë ligj zbatuese të BE-së përfshirë Europolin dhe Eurojust-in duke marrë pjesë në një sërë operacionesh ndërkombëtare të zbatimit të ligjit.
- Progresit të shënuar në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të lidhura me krimin e organizuar, ku për vitin 2023 vlera e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara së bashku, është përlogaritur në rreth 41.5 milion Euro.
- Sigurimin dhe forcimin e etikës në punë, nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore konkrete, si dhe avancimi i mëtejshëm i punës për plotësimin e kuadrit rregullator për vlerësimin e riskut të brendshëm, lidhur me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
- Fuqizimit të kapaciteteve hetimore kryesisht në hetimet financiare dhe pasurore me veprime komplekse brenda dhe jashtë vendit, ku përfshihen edhe veprimet me kriptovaluta.
- Përmirësimit të bazës logjistike në drejtim të ekspertimit të provave digjitale dhe përditësimin e laboratorit ekzistues me programet e fjalës së fundit.
- Përfundimit të verifikimeve të plota nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për Prokurorinë dhe GJKKO, për 60 kandidatë për personel administrativ ne Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe vazhdimin e procesit për 13 kandidatë për Gjyqtarë në GJKKO.
- Informimit të publikut për punën e Prokurorisë së Posaçme, nëpërmjet administrimit të përgjigjeve për 128 kërkesat për informacion të paraqitura për vitin 2023, ku interes më të shtuar kanë paraqitur ato të lidhur me hetimet në kuadër të veprave penale të krimit të organizuar, si dhe ato për qëllime terroriste, korrupsionin aktiv dhe pasiv të funksionarëve që ushtrojnë funksione publike.

Kuvendi kërkon që Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për vitin 2024, të angazhohet veçanërisht dhe në këto drejtime:

1. Të hartohet një strategji e posaçme për prioritizimin e çështjeve dhe procedimeve të mbartura;
2. Të intensifikohen hetimet paralele financiare për rastet e krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm, terrorizmit dhe pastrimit të parave.
3. Të vijojë angazhimin në sigurimin e aplikimit të uniformizuar të standardeve të hetimit dhe ndjekjes penale, duke garantuar barazinë para ligjit.
4. Të vijohet me forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike me fokus hetimet financiare e të kriptovalutave.
5. T’i kushtohet vëmendje krimeve zgjedhore, veçanërisht fakteve të bëra publike në media para, gjatë dhe pas procesit zgjedhor, për të filluar hetimin kryesisht në rastet kur ka njoftime publike për kryerjen e një vepre penale.
6. Të tregohet një vëmendje e shtuar ndaj denoncimeve që vijnë nga publiku si dhe të rritet numri i hetimeve të kryera nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme për çështje me ndjeshmëri të lartë publike.

7. Të angazhohet në plotësimin e vakancave me qëllim funksionimin në efikasitet të plotë të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.
8. Të përmbyllë procesin e hartimit dhe miratimit të akteve të tjera nënligjore të cilat rezultojnë pa miratuar, për të përfunduar plotësimin e kornizës strategjike institucionale.
9. Të angazhohet në pilotimin dhe testimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, me qëllim vënien në efikasitet brenda vitit 2024, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij sistemi në punën e Prokurorëve dhe Hetuesve të strukturës.
10. Të angazhohet në përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritetit në Bashkimin Europian.